KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Në:	**KSC-BC-2023-11**
Vendosi:	**Kryetarja e Dhomave të Specializuara**
	Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Administratorja:	Fidelma Donlon
Data:	22 nëntor 2023
Gjuha:	Anglishte
Titulli i dosjes:	**Caktimi i vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës**
Klasifikimi:	**Rreptësisht Konfidencial dhe ex parte**

VENDIM

mbi Caktimin e Vendit të Zhvillimit të Procedurës në Shtetin Pritës

---

Gjykatësit të Procedurës Paraprake:
Gjykatës Nikola Giju

Prokurores së Specializuar:
Kimberli P. Uest

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke vepruar në bazë të nenit 3(6) dhe (8)(a) dhe (d) të Ligjit Nr. 05/L053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), nenin 3 të Marrëveshjes me Shtetin Pritës dhe rregullën 82(3) të Rregullores së Procedurës dhe Provave ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim për caktimin e vendit të procedurës në shtetin pritës për procesin e filluar sipas nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86 të Rregullores, për të gjitha procedurat dhe aspektet e tjera që burojnë prej tij.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 20 nëntor 2023, Prokurorja e Specializuar njoftoi Kryetaren, në pajtim me rregullën 86(1) të Rregullores, për një aktakuzë që do të dorëzohej dhe kërkoi caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake në pajtim me nenin 33(1)(a) të Ligjit.

2. Më 20 nëntor 2023, Kryetarja caktoi gjykatësin Nikola Giju si gjykatës të procedurës paraprake në çështjen aktuale.[1]

3. Në të njëjtën ditë, Zyra e Prokurorit të Specializuar dorëzoi Parashtrimin e Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesave në lidhje me Të, me Shtojcat 1-3 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* ("Aktakuza"),[2] ku, ndër të tjera, "kërkoi caktimin e vendit të zhvillimit të procesit në shtetin pritës në lidhje me këtë proces dhe të gjitha fazat e ardhshme të procesit që burojnë ose kanë lidhje me Aktakuzën".[3]

II. VENDI I ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS

4. Duke marrë parasysh parashtrimet e Prokurores së Specializuar, Kryetarja gjykon se gjendja aktuale e sigurisë dhe administrimi i duhur i drejtësisë bëjnë të domosdoshme caktimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës. Ky

[1] F00001, Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, 20 nëntor 2023 (konfidencial).
[2] F00002, Parashtrimi i Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesave në lidhje me Të, me Shtojcat 1-3 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, 20 nëntor 2023 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*).
[3] Aktakuza, para. 5.

caktim ka të bëjë me procedurat në këtë çështje sipas nenit 38(4) të Ligjit, rregullës 86 të Rregullores, si dhe procedura dhe aspekte të tjera që burojnë prej tyre. Kjo siguron zhvillim të efikas, të efektshëm dhe të sigurt të këtyre procedurave.

III. KLASIFIKIMI I VENDIMIT

5. Meqenëse vendimi aktual u referohet parashtrimeve që aktualisht janë klasifikuar si konfidenciale, dhe hetimet e Prokurores së Specializuar dhe procedurat para gjykatësit të procedurës paraprake vazhdojnë të jenë konfidenciale dhe *ex parte*, ky vendim mban të njëjtin klasifikim. Vendimi aktual mund të riklasifikohet në një datë të mëvonshme, në pajtim me rregullën 82(5) të Rregullores, nëse arsyet për klasifikimin aktual pushojnë së ekzistuari.

PËR KËTO ARSYE, KRYETARJA

CAKTON vendin e zhvillimit të procedurës në shtetin pritës për procedurat në këtë çështje, në bazë të nenit 38(4) të Ligjit, rregullës 86 të Rregullores, si dhe për të gjitha procedurat dhe aspektet e tjera që burojnë prej tyre; dhe

KËRKON nga Administratorja që të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi.

/nënshkrimi/
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E mërkurë, 22 nëntor 2023

Në Hagë, Holandë.